VENDIM
Nr. 272, datë 4.5.2023

PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË CENTRALIT GJENERUES TË ENERGJISË ELEKTRIKE FOTOVOLTAIKE DHE VEPRAVE NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, NË ZONËN KADASTRALE NR. 1020, FSHATI ALLPRENAJ, NJËSIA ADMINISTRATIVE GOLEM, BASHKIA LUSHNJË, QARKU FIER, NGA SHOQËRIA "*5GX ENERGY*" SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier, nga shoqëria "*5GX ENERGY*" sh.p.k., me elementet, si më poshtë vijon:

a) Emri i aplikuesit: Shoqëria "*5GX ENERGY*" sh.p.k.;

b) Numri i identifikimit personal, NIPT/NUIS: M27511801Q;

c) Tipi centralit: Fotovoltaik;

ç) Kapaciteti i instaluar: 10 mw;

d) Afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: Koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të parkut fotovoltaik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

dh) Vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: Në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, njësia administrative Golem, Bashkia Lushnjë, qarku Fier;

e) Afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;

ë) Koordinatat e tokës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit;

g) E drejta për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, njësia administrative Golem, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier, e dhënë sipas këtyre rregullave, mund të transferohet te një subjekt i tretë, vetëm me miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;

gj) Shoqëria "*5GX ENERGY*" sh.p.k., ka detyrimin që:

i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të centralit fotovoltaik;

ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;

iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë "*5GX ENERGY*" sh.p.k., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera që lidhen me zbatimin e saj;

iv. t'i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t'i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria "*5GX ENERGY*" sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKSI 1

Koordinatat e Centralit Elektrik Fotovoltaik Në zonën kadastrale nr. 1020, fshati Allprenaj, njësia administrative Golem, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier Shoqëria "*5GX ENERGY*" sh.p.k.					
Nr.	**E**	**N**	**Nr.**	**E**	**N**
1	474417.65	4536806.74	11	474646.77	4536581.09
2	474504.84	4536811.43	12	474582.15	4536531.84
3	474594.1	4536845.71	13	474466.88	4536629.3
4	474635.16	4536807.02	14	474484.19	4536704.85
5	474649.08	4536842.31	15	474457.12	4536739.07
6	474784.65	4536777.84	16	474427.69	4536786.41
7	474747.42	4536612.61	17	474589.49	4536748.26
8	474770.98	4536568.32	18	474594.79	436756.54
9	474745.59	4536513.14	19	474523.79	4536785.6
10	474658.29	4536572.2	20	474420.31	4536797.54

PLAN VENDOSJE

OBJEKTI: **"5GX ENERGY SOL PARK, 10MW"**

VENDODHJA : Zona Kadastrale 1020, Fshati Allprenaj, Njësia Administrative Golem, Bashkia Lushnje, Qarku Fier, Shqiperi.

ZHVILLUESI: **Shoqëria "5GX ENERGY" sh.p.k**

HARTOI: DELTA PLAN STUDIO
LICENCE N.7039, Ing Elektrik Entela PONARI

NUMRAT E PASURIS	
1	169/46
2	169/49
3	169/51
4	170/16
5	173/12

KRGJSH



SHKALLA 1:25000

Siperfaqe 75881m2

Entela Ponari

Pavlina Qosja

Agim Kojku

KORDINATAT NE KRGJSH

NR	E	N	NR	E	N	NR	E	N
1	474417.65	4536806.74	7	474747.42	4536612.61	14	474484.19	4536704.85
2	474564.84	4536811.43	8	474730.98	4536568.32	15	474457.72	4536739.07
3	474594.1	4536845.71	9	474745.59	4536513.54	16	474427.69	4536785.41
4	474635.16	4536807.02	10	474658.29	4536572.3	17	474503.49	4536748.26
5	474649.08	4536842.31	11	474646.77	4536581.09	18	474594.79	4536756.54
6	474784.65	4536777.84	12	474582.15	4536531.84	19	474523.79	4536785.6
			13	474466.88	4536629.3	20	474420.31	4536737.54